

PHI LAN THR OPY

edicioni 11

*Hapësirë e dedikuar mbështetjes së nismave
komunitare dhe kauzave sociale*

#philanthropy

kontakt :   



©PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

TIRANË, SHQIPËRI

Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Fondit Rockefeller Brothers. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondit Rockefeller Brothers.

PHI LAN THR OPY

*Hapësirë e dedikuar mbështetjes së nismave
komunitare dhe kauzave sociale*

Në këtë edicion



5

Rreth revistës

7

Të dhëna rreth
aktivitetit filantropik

janar - dhjetor 2025

22

Rrathë Dhurues

28

Smile.al

Publikohen shtatë
iniciativa të reja

31

**Intervista me përfaqësues
të nismave filantropike në
vend**

Znj. Orjola Driza

Instituti i Nxënësve që nuk Dëgjojnë

38

**Fushata në ndihmë të
personave në nevojë**

42

**Fondacionet
Komunitare**

Mirë se vini në edicionin e 11 të revistës Philanthropy!

Revista *Philanthropy* prej gjashtë vitesh vijon të jetë një burim i rëndësishëm informacioni mbi zhvillimin e aktivitetit filantropik në vend, duke reflektuar angazhimin në rritje të individëve, bizneseve dhe organizatave për të ndërtuar një shoqëri më solidare dhe gjithëpërfshirëse.

Monitorimi i **aktivitetit filantropik** përmes medias dhe platformave online, ofron një panoramë të detajuar të dhurimeve dhe trendeve kryesore për vitin 2025. Në këtë edicion do të njiheni me fakte konkrete, të dhëna statistikore dhe histori frymëzuese nga vendi.

"**Rrathë Dhurues 2025**", i organizuar në tetor 2025, mundësoi sigurimin e mbështetjes financiale në shumën 2,214,628 Lekë, përmes dhurimeve individuale, të biznesit dhe OJF-ve, në mbështetje të tre nismave të reja komunitare.

Platforma Smile.al prezantoi shtatë nisma të reja në fushat e mirëqenies sociale, arsimit, trajnimit dhe inovacionit, duke krijuar ura bashkëpunimi mes donatorëve dhe komuniteteve lokale në nevojë.

R r e t h e s h



Në këtë edicion kemi kënaqësinë t'ju prezantojmë me znj. **Orjola Idrizi**, Drejtore e "Qendrës Burimore për nxënësit që nuk dëgjojnë". Si mësuese, drejtuese dhe hartuese kurrikulash, ajo ka ndikuar drejtpërdrejt në formimin e brezave dhe në zhvillimin profesional të mësuesve që punojnë me këtë kategori nxënësis

Fushatat në ndihmë të grupeve në nevojë vijojnë të jenë një fokus i rëndësishëm i këtij edicioni, duke treguar se filantropia nuk është vetëm dhurim, por një investim në dinjitetin njerëzor.

Po ashtu, do të njiheni me raportin kombëtar "**Fondacionet Komunitare në Shqipëri**", vlerësimi i parë i thelluar mbi krijimin dhe rolin e fondacioneve komunitare në vend, një hap i rëndësishëm drejt forcimit të kulturës së dhurimit dhe pjesëmarrjes qytetare.

Nëse keni komente mbi artikujt e këtij edicioni apo dëshironi të bëheni pjesë e edicionit të ardhshëm, ju ftojmë të na shkruani në: **partners@partnersalbania.org**

Lexim të këndshëm!

T Ë D H Ë N A R R E T H A K T I V I T E T I T F I L A N T R O P I K

J A N A R - D H J E T O R 2 0 2 5


Të dhënat e mëposhtme pasqyrojnë aktivitetin filantropik në Shqipëri **gjatë vitit 2025**, bazuar në monitorimin ditor të mediave, përfshi ato sociale, si dhe përmes raportimeve dhe publikimeve të institucioneve publike dhe jopublike. Raporti analizon fushat dhe çështjet kryesore që janë mbështetur, numrin dhe vlerën e dhurimeve, mbulimin gjeografik të dhuruesve dhe përfituesve, etj.

Nëpërmjet këtij monitorimi, Partnerët Shqipëri synon të rrisë vetëdijen publike mbi aktivitetin filantropik dhe të informojë të gjithë aktorët e përfshirë dhe të interesuar mbi impaktin dhe vlerën sociale të tij. Gjatë vitit 2025, u regjistrua një numër prej **105,022 dhurimesh** me një vlerë dhurimi prej **482,550,639 Lekë** (4,974,748 Euro).


Krahasuar me vitin 2024, u shënua një rënie prej 2.2% (*-2,406 dhurime*) në numrin e dhurimeve, si dhe një ulje prej 8.4% (*-44,476,209 Lekë*) në vlerën totale të dhurimeve, duke reflektuar një nivel më të ulët të kontributit financiar.

Numri i dhurimeve sipas natyrës

- Monetare (99.24%)
- Miks (0.40%)
- Mallra/Produkte (0.20%)
- Punë Vullnetare (0.11%)
- Shërbime Profesionale (0.05%)



Vlera sipas natyrës së dhurimit në Lekë



Dhurimet sipas formës

Fjalorth


Tre format kryesore të mbledhjes së dhurimeve janë përmes **Eventeve**, **Fushatave** dhe në formë të **Drejtëpërdrejtë**.

582 dhurime përmes Eventeve

180 dhurime në formë të Drejtëpërdrejtë

104,260 dhurime përmes Fushatave

Vlera e dhurimeve sipas formës



Dhurim i drejtëpërdrejtë - Dhurimi që kryhet direkt nga dhuruesi tek përfituesi

Fushata për ngritjen e fondeve - Mbledhje e fondeve që ndodh gjatë një periudhe të caktuar kohe për një kauzë të caktuar sociale

Evente - Është një ngjarje që organizohet në kuadër të mbledhjes së fondeve për një kauzë të caktuar

Zbutja e Varfërisë - Dhurimet që janë kryer për zbutjen e varfërisë për individë apo familje që jetojnë në vështirësi ekonomike apo të prekur nga fatkeqësitë e mëparshme natyrore

Dhurime Sezonale - Dhurime që kryen gjatë sezonit të festave

Publik i Gjerë - Përfituesit e dhurimeve apo iniciativave që kanë një impakt në publikun e gjerë.

Miks - Dhurime të cilat kombinohen nga më shumë se një kategori / qytet

NVM - Ndërmarrje të vogla dhe të mesme

Platforma Crowdfunding (Individë apo familje) - dhurimet që kanalizohen përmes platformave online crowdfunding, të krijuara nga individë apo familje

Platforma Crowdfunding (OJF) - dhurimet që kanalizohen përmes platformave online crowdfunding, të krijuara nga OJF-të

Institucione Private - Biznese

Tjetër - Cdo kategori tjetër që nuk i përket kategorive të mëparshme.

3 DHURUESIT KRYESOR

sipas numrit të dhurimeve

#1 Shpresë për Botën (40)

#2 Credins Bank (37)

#3 Fundjavë Ndryshe (26)

3 DHURIMET KRYESOR

sipas vlerës së dhurimeve

#Dhurues Individë **14,484,060 Lekë**

Fushatë për mbledhjen e fondeve "Bamirësia që Ndriçon – Shtëpi për Jetimët!", në mbështetje të pesë familjeve me jetimë që jetojnë në kushte të vështira.

#Dhurues Individë **13,908,216 Lekë**

Fushatë për mbledhjen e fondeve "Të shpëtojmë jetën e Amarildos 16 vjeçar me leuçemi!", në mbështetje të Amarildos, i cili ndodhet në gjëndje të rëndë shëndetësore.

#Dhurues Individë **13,897,520 Lekë**

Fushatë për mbledhjen e fondeve "Të shpëtojmë jetën e 3 vajzave, Dajmas, Alteas dhe Danielës!", në mbështetje të tre vajzave, të cilat ndodhen në gjëndje të rëndë shëndetësore.

Fushata për ngritjen e fondeve

414

Thirrje për Dhurime

167

Fushata përmes Medias Sociale & Platformave Crowdfunding

49

Fushata përmes platformave Crowdfunding

32

Megafushata

2

Fushata përmes platformës Facebook për Impaktin Social*

Evente


582

Evente live

*Platforma e dedikuar e Facebook për ngritje fondesh për kauza sociale.

Numri i dhuruesve sipas natyrës*


- Individë (50.65%)
- E panjohur (49.12%)
- Biznes i madh (0.10%)
- OJF (0.06%)
- NVM (0.04%)
- Entitetet fetare (0.01%)
- Institucion privat (0.01%)
- Institucion ndërkombëtar (0.01%)




*Në kuadër të kësaj analize, dhuruesit llogariten vetëm një herë, pavarësisht nga numri i dhurimeve të kryera gjatë procesit të monitorimit.

Vlera sipas natyrës së dhuruesit

- Institucion privat
- Entitete fetare
- NVM
- OJF
- Biznes i madh
- Institucion ndërkombëtar
- E panjohur
- Individë
- Totali




Përfituesit Përfundimtar



- Fëmijë dhe të rinj (46.85%)
- Publik i gjerë (43.38%)
- Individë/Familje (9.48%)
- Tjetër (0.29%)



- Në vështirësi ekonomike, shëndetësore dhe sociale (72.96%)
- Zonë specifike (12.76%)
- Të talentuar (9.57%)
- Fëmijë dhe të rinj (2.6%)
- Komunitet minoritar (2.11%)




- Në vështirësi ekonomike, shëndetësore dhe sociale (67.34%)
- Të moshuar (25.3%)
- Gra dhe vajza - Në rrezik (7.36%)



- Publik i gjerë (41.53%)
- Në vështirësi ekonomike, shëndetësore dhe sociale (36.02%)
- Komunitet fetar (13.63%)
- Komunitet minoritar (8.23%)
- Zonë specifike (0.6%)

Shpërndarja Gjeografike e Përfituesve

Gjatë vitit 2025, **99.71%** e dhurimeve u shpërndanë në Shqipëri, ndërsa pjesa tjetër jashtë vendit siç është paraqitur grafikisht më poshtë:



* Lushnje, Berat, Përmet, Tepelenë, Pukë, Sarandë, Laç, Gjirokastër, Bulqizë, Ersekë, Skrapar, Mallakastër.

E panjohur



0.24%

Kosova




0.04%

Shtete të tjera





0.01%




Shpërndarja Gjeografike e Dhuruesve

86.48% e dhurimeve janë kryer nga dhurues nga Shqipëria, ndërsa pjesa tjetër nga dhurues nga Diaspora dhe shtete të tjera.



* Korçë, Lezhë, Lushnjë, Vlorë, Sarandë.



Diaspora



12.76%

E panjohur



0.33%

Shtete të tjera



0.13%

Kosova




0.01%

Qëllimi i dhurimit


Gjatë vitit 2025 **3** fushat kryesore të dhurimeve janë si më poshtë:

- Shëndetësi
- Mbështetje e grupeve të marginalizuara
- Aktivitete humanitare me bazë fetare
- Tjetër



Ndërkohë kategoria "Tjetër" përfshinë dhurimet e kryera për: Përgjigje ndaj fatkeqësisë natyrore (0.62%), Zbutja e varfërisë (0.51%), Edukim (0.19%), Infrastrukturë publike (0.08%), Dhurime sezonale (0.06%), Art dhe kulturë (0.06%), Zhvillimi ekonomik (0.03%), Ruajtjen dhe mbrojtja e mjedisit (0.03%), Sport (0.02%), Zhvillimi i komunitetit (0.02%) Trashëgimia (0.01%), Shkencë (0.01%) etj.

Kanalet e dhurimit



A word cloud graphic featuring the number '1014' in large black font. Surrounding the number are various media-related terms in red, including 'ARTIKUJ', 'EMISIONE', 'LAJME', 'REPORTAZHE', 'KRONIKA', and 'POSTIME'. The words are arranged in a circular pattern around the central number. Below the number, the text 'lajme në media' is written in bold black font.

1014

lajme në media

Gjatë vitit 2025, u gjurmuan 1014 artikuj në median e shkruar, audiovizive dhe atë sociale, të cilat mbulojnë fushata dhe iniciativa dhuruese. Platforma më e zakonshme për këtë promovim ka qenë media sociale Facebook, që është një nga kanalet e preferuara për shpërndarjen e informacionit rreth rasteve të dhurimit.


Njëkohësisht, media vizive ka prodhuar një numër të konsiderueshëm emisionesh dhe reportazhesh të fokusuara në çështje të cilat kanë patur nevojë për mbështetje. Faqet zyrtare të internetit të institucioneve publike kanë vazhduar të jenë një burim i rëndësishëm për promovimin dhe raportimin e zhvillimeve në fushën e dhurimit.

FILANTROPIA DHE SEKTORI JOFITIMPRURËS


Të dhënat nga monitorimi vjetor i aktiviteti filantropik dëshmojnë se sektori jofitimprurës zë një rol qendror në ekosistemin e dhurimeve në Shqipëri, pasi 58% e vlerës totale të financimit lidhet me OJF-të, qoftë si përfitues të drejtëpërdrejtë të fondeve, qoftë si kanale ndërmjetësuese për mobilizimin dhe shpërndarjen e dhurimeve, duke reflektuar një rol të konsoliduar të tyre në adresimin e nevojave sociale dhe humanitare. Brenda këtij financimi, struktura sipas formës së dhurimit tregon një dominim të theksuar të fushatave, të cilat gjenerojnë 97% të vlerës së dhurimeve për OJF-të, ndonëse përbëjnë rreth dy të tretat e rasteve, ndërsa dhurimet direkte dhe eventet mbeten plotësuese me peshë shumë të kufizuar në vlerë.

Paralelisht, analiza sipas natyrës së dhurimit tregon një mbizotërim pothuajse absolut të dhurimeve monetare, të cilat përbëjnë 99.24% të totalit. Ky rezultat sugjeron se filantropia në këtë kontekst mbështetet kryesisht në kontribute financiare direkte, ndërsa format e tjera të dhurimit, si dhurimet në natyrë apo ofrimi i shërbimeve, mbeten minimalisht të shfrytëzuara. Kjo prirje reflekton një qasje tradicionale ndaj filantropisë, e cila, ndonëse siguron fleksibilitet dhe lehtësi në përdorimin e fondeve, njëkohësisht evidenton potencial të pashfrytëzuar për diversifikimin e instrumenteve filantropike.

Forma e
dhurimit




Natyra e
dhurimit



Qëllimi i dhurimit


- Mbështetje e grupeve të marginalizuara
- Zbutja e varfërisë
- Shëndetësi
- Edukim
- Tjetër



Analiza e shpërndarjes së përfituesve përfundimtarë tregon një fokus të theksuar të filantropisë në grupet në nevojë ekonomike dhe kategoritë vulnerabël, me 20% të përfituesve që i përkasin individëve në nevojë ekonomike dhe 15% fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara. Një peshë e konsiderueshme i kushtohet gjithashtu fëmijëve dhe të rinjve pa kujdes prindëror (13%) dhe atyre me probleme shëndetësore (10%), duke reflektuar një orientim të fortë social dhe mbrojtës. Mbështetja për fëmijët dhe të rinjtë e talentuar (8%) dhe për popullatën e përgjithshme (6%) tregon edhe elementë të zhvillimit të potencialit njerëzor. Ndërkohë, kategori të tilla si të rriturit me aftësi të kufizuara, të moshuarit, të pastrehët, prindërit e vetëm dhe komunitetet minoritare përfaqësohen me përqindje më të ulëta, çka sugjeron se filantropia mbetet kryesisht e orientuar drejt mbështetjes sociale dhe nevojave imediate.


Kategoritë e përfituesve

- Publik i gjerë, Vështirësi ekonomike (19.96%)
- Fëmijë dhe të rinj, PAK (15.51%)
- Fëmijë dhe të rinj, Pa përkujdesje prindërore (12.66%)
- Fëmijë dhe të rinj, Probleme shëndetësore (10.16%)
- Fëmijë dhe të rinj – Të talentuar (8.38%)
- Publik i gjerë (6.42%)
- Tjetër (26.92%)



Vlera e dhurimeve

Mijë Lekë



Edhe pse nuk parashikohen lehtësira tatimore për dhurimet individuale, individët përbëjnë vlerën më të madhe të dhurimeve, ndërsa kontributi i bizneseve të mëdha, OJF-ve dhe institucioneve private mbetet minimal, kjo bazuar në të dhënat e bëra publike. Kjo situatë reflekton, ndër të tjera, mungesën e transparencës së strukturuar në praktikat filantropike të biznesit, si dhe mungesën e mekanizmave nxitës dhe rregullatorë që do të inkurajonin angazhimin e qëndrueshëm dhe të deklaruar të bizneseve dhe institucioneve private në mbështetje të interesit publik.

22

R R A T H Ë D H U R U E S

1 7 T E T O R 2 0 2 5

Në tetor 2025 u organizua event i shtatë "Rrathë Dhurues".

"Rrathë Dhurues" është një event i përvitshëm i dhurimeve live, që prej vitit 2018, i cili u jep individëve mundësinë të kontribuojnë drejtpërdrejt për mbështetjen e nismave komunitare që adresojnë nevoja të komuniteteve vulnerabël. Përmes shtatë eventeve, janë mbështetur 22 nisma komunitare në vend falë dhurimeve të individëve, bizneseve dhe organizatave të shoqërisë civile, në një vlerë totale prej 16,296,244 Lekë.



#RrathëDhurues
Shqipëri

RRATHË DHUR



Më 17 tetor të vitit që lamë pas, shuma totale prej **2,214,628 Lekë**, e siguruar falë dhurimeve individuale, të bizneseve dhe OJF-ve, do të shërbejë për të sjellë në jetë tre nisma në Mat, Dibër dhe Korçë. Kjo shumë e tejkaloi objektivin fillestar prej **900,000 Lekë**, duke konfirmuar sërish ndjenjën e lartë të solidaritetit qytetar ndaj komuniteteve në nevojë.

Kontributet e mbledhura përmes eventit, po mbështesin iniciativat e mëposhtme:

UES 2025



Bankina që Dëgjon

Në Shqipëri, hapësirat publike shpesh mbeten të papërshtatura për personat me aftësi të kufizuara. Kjo jo vetëm që u kufizon mundësinë për të lëvizur lirshëm, por edhe i izolon nga pjesëmarrja e barabartë në jetën komunitare.

“Bankina që dëgjon” është një nismë unike komunitare që sjell një risi në peizazhin urban të Matit, një bankinë simbol i informimit, aksesueshmërisë dhe gjithëpërfshirjes. Ajo do të sjell vlerë arkitektonike e sociale duke rritur ndërgjegjësimin për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe mundësuar ndërveprimin me komunitetin lokal. Përmes kodeve QR, qytetarët dhe vendimmarrësit do të mund të njihen me histori reale dhe barrierat që pengojnë përditshmërinë e këtij grupi në fokus. Ky kombinim i teknologjisë me mobilimin urban e kthen bankinën në një mjet edukimi, frymëzimi dhe thirrjeje për një shoqëri më të hapur e gjithëpërfshirëse. “Bankina që dëgjon” është hapësira e parë e këtij lloji në Shqipëri që ndërthur dizajnin urban me rrëfimin e historive.



MALGA, Mal-Gur-Ajër

Parku Kombëtar ‘Lurë-Mali i Dejës’, me sipërfaqe 19,288.88 hektarë, pyje dhe 12 liqene akullnajore, është dëmtuar rëndë nga prerjet ilegale dhe zjarret për mbi tre dekada. Nisma MALGA synon të rikthejë gjelbërimin përmes metodës Fukuoka, të njohur si “topthat e farave”, një teknikë e qëndrueshme që imiton rigjenerimin natyror të pyjeve.

Faza e parë parashikon ripyllëzimin e 30 hektarëve me 75,000 grupe farash të përgatitura për t’u mbjellë nga komuniteti lokal, ndërsa vizioni afatgjatë synon rigjenerimin e gjithë parkut brenda pesë viteve, duke mbrojtur speciet e rralla dhe biodiversitetin. Përfshirja e banorëve dhe nxënësve në proces krijon ndjenjë përgjegjësie dhe kujdesi ndaj natyrës, duke e kthyer MALGA-n në një model unik për Shqipërinë dhe rajonin mbi përdorimin e zgjidhjeve natyrore për restaurimin e pyjeve dhe fuqizimin e komuniteteve.

Mbështetja juaj sot, është garancia për një Lurë më të gjelbër, të qëndrueshme dhe me komunitet të ndërgjegjësuar për të ardhmen.



Krijuesit e rinj korçarë të së ardhmes

“Krijuesit e rinj korçarë të së ardhmes” është një nismë që mbështet rreth 50 të rinj të moshës 14–22 vjeç në qytetin e Korçës për zhvillimin e disa ideve novatore, dhe zbatimin praktik të tyre.

Përmes mbështetjes së siguruar do të mundësohet realizimi i “kampeve për të rinjtë”, (sigurimi ambjentëve fizike, mentorëve, mjeteve dhe materialeve të duhura), në mbështetje të këtij grupi në fokus duke iu mundësuar transformimin e ideve novatore në produkte specifike që adresojnë nevoja në një seri fushash si energjia, mjedisi, zhvillimi teknologjik etj.

Nisma përfshin dhe mobilizon shkollat, universitetin, bizneset dhe OJF-të lokale, për të siguruar një rrjet bashkëpunëtorësh afatgjatë me kontribut në qëndrueshmërinë e nismës.







S M I L E . A L

W W W . S M I L E . A L

Platforma Smile.al ofron një mundësi tjetër për mbledhjen e fondeve online, në mbështetje të nismave komunitare në fushat e shëndetit, solidaritetit, trashëgimisë kulturore, mjedisit, sipërmarrjes sociale dhe inovative, edukimit e trajnimit, dhe aktivitetet sportive.

Njihuni me iniciativat e reja të prezantuara në platformë, të cilat kanë nevojë për mbështetjen tonë:

7 INICIATIVAT



Fuqizimi i Liderëve të Ardhshëm të Teknologjisë nga Korça

Ndihmoni 5 të rinjtë më të dalluar nga kampi veror i Korça ICT Academy & Code for Albania të zhvillojnë aftësitë e tyre në programim dhe teknologji përmes kurseve të avancuara. Secili do të përfitoj një bursë 1,000 USD dhe mundësi lidhjeje me profesionistë nga diaspora. Ndihmo të ndjekin pasionin, të krijojnë ide inovative dhe të frymëzojnë bashkëmoshatarët e tyre! Për më shumë rreth nismës klikoni: [këtu](#)



Fuqizo një grua – Ndrysho një komunitet!

Ky projekt synon të lidhë çdo cep të Shqipërisë rurale jetojnë gra me ide të mëdha, pasion dhe forcë të jashtëzakonshme. Me mentorim të dedikuar, trajnime praktike dhe një platformë digjitale, ne i ndihmojmë të bëhen lidere të agroturizmit modern, të hapin bujtina autentike dhe të krijojnë përvoja turistike që promovojnë traditën lokale dhe prodhimet e fshatit. Për më shumë rreth nismës klikoni: [këtu](#)



Kujdes për Fëmijët

Ndihmo fëmijët e moshës 11–14 vjeç të ruajnë shëndetin e tyre! Projekti "Kujdes për Fëmijët" kryen kontrolle posturale në shkolla publike të Tiranës, duke identifikuar në kohë deformimet e shtyllës kurrizore dhe duke ofruar udhëzime për trajtim të mëtejshëm. Dhuro dhe ndihmo mbi 1,000 fëmijë të rriten të shëndetshëm dhe të parandalojnë probleme të ardhshme! Për më shumë rreth nismës klikoni: [këtu](#)



AI EduLiteracy

Ndihmo mësuesit të udhëheqin nxënësit drejt përdorimit të përgjegjshëm të Inteligjencës Artificiale! AI EduLiteracy, synon të trajtojë mbi 1,000 mësues në të gjithë Shqipërinë përmes kurseve falas, materialeve udhëzuese, webinarëve dhe workshop-eve lëvizëse. Dhuro dhe bëhu pjesë e këtij ndryshimi historik – më shumë mundësi për nxënësit, më pak hendek digjital dhe një arsim i fuqizuar nga dijet dhe përgjegjësia! Për më shumë rreth nismës klikoni: [këtu](#)

TË REJA



Një Investim në Arsimit dhe Kulturë

Pas tërmetit të 2019, Thumana është ringritur, por fëmijët dhe të rinjtë kanë nevojë për një vend ku të lexojnë, mësojnë dhe ëndërrojnë. Qendra Kulturorë "Atrium Center" mund të kthehet në një bibliotekë të vërtetë për mbi 17,000 banorë dhe pesë shkolla lokale. Dhuro dhe ndihmo të sigurojmë libra, mobilim dhe një hapësirë të sigurt për fëmijët dhe komunitetin! Për më shumë rreth nismës klikoni: [këtu](#)



Të rritemi së bashku

Në Shqipërinë rurale, shumë fëmijë me aftësi të kufizuara nuk kanë hapësira të përshtatura dhe përfshirje. Projekti "Të Rritemi Së Bashku" do të krijojë në Rrëshen një qendër multisensore ku fëmijët mund të zhvillohen përmes lojës, artit dhe muzikës, dhe ku prindërit dhe mësuesit do të marrin mbështetje dhe njohuri për përfshirje. Dhuro dhe ndihmo çdo fëmijë të rritet me dinjitet dhe gëzim! Për më shumë rreth nismës klikoni: [këtu](#)



Luajmë Bashkë

Në Fushë-Krujë, shumë fëmijë, veçanërisht nga komuniteti rom, nuk kanë një vend të sigurt dhe gjithëpërfshirës ku të luajnë. Projekti synon të krijojë një kënd lojërash të sigurt dhe gjithëpërfshirës, ku fëmijët të zhvillojnë imagjinatën, aftësitë sociale dhe të mësojnë të bashkëjetojnë, ndërsa komuniteti përfitojnë nga një hapësirë që nxit ndërveprimin dhe solidaritetin. Ky projekt është një investim në shëndetin, edukimin dhe të ardhmen e fëmijëve, dhe me mbështetjen tuaj mund të japim jetë një këndi lojërash që ndryshon realitetet. Për më shumë rreth nismës klikoni: [këtu](#)



N G A D H U R I M I T E
T R A N S F O R M I M I
I N S T I T U C I O N A L





M B Ë S H T E T J E
P Ë R T Ë R I N J T Ë
M E A F T Ë S I
N D R Y S H E

Orjola Idrizi



Drejtoreshë "Qendra Burimore për Nxënësit që nuk Dëgjojnë"

Znj. Orjola Idrizi me një përvojë mbi 20-vjeçare në arsim, ka luajtur një rol të rëndësishëm si hartuese e programeve lëndore në lëndën e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë, si hartuese e testeve kombëtare, korrigjuese në provimet e Maturës Shtetërore si në arsimin e zakonshëm ashtu edhe në arsimin special. Ajo ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e edukimit për nxënësit që nuk dëgjojnë, si mësuese, drejtuese dhe hartuese kurrikulash si dhe mbështet vazhdimisht zhvillimin profesional të mësuesve që punojnë me nxënës me vështirësi në dëgjim.

Cilat kanë qenë dhurimet që institucioni juaj ka përfituar ose menaxhuar në bashkëpunim me aktorë privatë? Cilat kanë qenë format kryesore të këtyre dhurimeve?

Pyetja juaj më sjell ndërmend një shprehje të Harvey B. Mackay “Ajo që kemi bërë vetëm për veten tonë vdes me ne. Ajo që kemi bërë për të tjerët dhe për botën mbetet dhe është e pavdekshme.”

“Qendra Burimore për nxënësit që nuk dëgjojnë” i kushton vëmendje të veçantë bashkëpunimit dhe menaxhimit të investimeve nga aktorë privatë, të cilat përfshijnë si investime infrastrukturore, si laboratorë, ashtu edhe dhurime, në formën e pajisjeve, materialeve, apo mjeteve të punës, të vëna në funksion të drejtpërdrejtë të veprimtarisë së institucionit. Po ashtu, ky bashkëpunim përfshin edhe shërbime të ofruara pa pagesë, si asistencë teknike, trajnime, këshillim profesional apo mbështetje logjistike. Investimet e partnerëve të ndryshëm kanë përmirësuar ndjeshëm proceset e funksionimit në qendër. Përfituesit kryesorë janë pikërisht nxënësit, të cilët shfaqin nivel më të lartë motivimi, vetëdijeje dhe aganzhimi në të nxënë dhe në aktivitetet sociale. Laboratorët, aktivitetet artistike dhe trajnimet u kanë krijuar mundësi të zhvillojnë aftësi praktike, komunikuese dhe profesionale.

Gjatë 4 viteve të fundit, kemi pasur bashkëpunime të suksesshme me rreth 34 partnerë, ndër të cilët përmendim Bashkimin Evropian në Shqipëri, Fondacionin për Shoqërinë e Hapur, Shoqata Kombëtare e Njerëzve që Nuk Dëgjojnë (ANAD), Shoqata “Effatha” Hollandë etj., falë të cilëve janë mundësuar ndryshime rrënjësore në institucionin tonë, si në rikostruksionin e godinës shkollore, qoftë në krijimin e laboratorit të audiogramës, sallës së trajnimeve, laboreve si ai i fotografisë, serës didaktike “Shtëpia e gjelbër”, laboratorit të poçerisë dhe qeramikës “Artlab” . Përfituesit kryesorë të investimeve janë 150 nxënës, 90 punonjes të stafit mbështetës dhe 100 prindër të cilët kanë përfituar trajnime të vlefshme.

Ndër bashkëpunëtorët tanë kryesorë, me të cilët kemi realizuar projekte shumë të rëndësishme për institucionin, është shoqata “Përtej Barrierave.” Një nga projektet më të dashura për nxënësit, të cilin ata e kanë mirëpritur shumë, ka qenë padyshim krijimi, në mjediset e qendrës, i Laboratorit të Artit dhe Qeramikës “Artlab”, një risi për institucionet arsimore shqiptare, e realizuar në bashkëpunim me Partnerët Shqipëri. Së bashku me nxënësit, u bëmë pjesë e eventit “Rrathë Dhurues 2025”, një event që mbledh së bashku individë dhe biznese, të cilët përmes shembullit të tyre personal, dhurojnë në mbështetje të kauzave sociale duke treguar një ndjenjë të lartë solidariteti njerëzor. Në kuadër të veprimtarisë së këtij laboratorit, në bashkëpunim me “Përtej Barrierave” u realizua edhe ekspozita “Duart që Flasin: Arti dhe Trashëgimia në Poçeri”, e konceptuar si një hapësirë për të promovuar krijimtarinë e të rinjve dhe për të njohur aftësitë e tyre si artizanë të rinj. Në këtë ekspozitë u prezantuan punimet e realizuara nga nxënësit si, vazo, pjata dhe objekte dekorative të punuara me dorë dhe të zbukuruar me motive tradicionale shqiptare. Pjesëmarrësit u certifikuan për aftësitë e fituara, ndërsa ekspozita shërbeu si platformë për të ndërtuar ura bashkëpunimi me komunitetin, institucionet kulturore dhe tregun e punës, duke krijuar mundësi të reja për integrimin e tyre social dhe profesional.



Disa nga aktivitetet

në #Qendrën Burimore për Nxënësit që nuk Dëgjojnë



Si kanë kontribuar dhurimet dhe/ose investimi realizuar në arritjen e objektivave strategjike dhe operacionale të institucionit tuaj?

Shpesh më vjen në mendje një thënie e Charles Darwin, i cili citon *“në historinë e njerëzimit kanë përparuar ata që kanë ditur të përshtaten dhe bashkëpunojnë”*. Kjo është shumë e vërtetë edhe për përvojën tonë. Investimet dhe bashkëpunimet që kemi ndërtuar ndër vite kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e institucionit tonë. Falë këtyre mbështetjeve, kemi arritur të forcojmë burimet tona financiare, teknike dhe njerëzore, duke përbushur objektiva si afatshkurtra ashtu edhe afatgjata. Në praktikë, kjo ka nënkuptuar rritje të kapaciteteve institucionale përmes pajisjeve, infrastrukturës, trajnimeve dhe asistencës teknike, si dhe përmirësim të dukshëm të cilësisë dhe eficiencës së shërbimeve që ofrojmë.

Po ashtu, këto bashkëpunime na kanë mundësuar të përshpejtojmë zbatimin e projekteve strategjike, të cilat pa këtë mbështetje do të ishin realizuar shumë më ngadalë ose nuk do të kishin qenë të mundshme. Një ndikim i rëndësishëm është parë edhe në proceset mësimore-edukative, ku kemi modernizuar metodat e punës, teknologjinë dhe organizimin e brendshëm. Në fund, ajo që ka më shumë rëndësi për ne është fakti se këto investime kanë zgjeruar ndikimin e veprimtarisë sonë në shërbim të nxënësve që nuk dëgjojnë, duke rritur njëkohësisht qëndrueshmërinë dhe inovacionin e institucionit përmes zgjidhjeve të reja dhe praktikave të mira të sjella nga bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm.

Cili ka qenë impakti i arritur deri më tani nga këto nisma?

Nismat e mbështetura përmes dhurimeve dhe investimeve, të realizuara në bashkëpunim me aktorë privatë, kanë prodhuar një impakt të dukshëm dhe të matshëm në disa nivele të veprimtarisë së institucionit tonë. Deri më tani, kemi bashkëpunuar me rreth 34 partnerë, përfshirë organizata, fondacione, biznese dhe institucione, të cilët kanë kontribuar jo vetëm financiarisht, por edhe me ekspertizë, trajnime dhe mbështetje teknike. Përfituesit kryesorë të këtyre nismave kanë qenë nxënësit që nuk dëgjojnë, por ndikimi është shtrirë edhe te mësuesit, stafi mbështetës, prindërit dhe komuniteti më i gjerë. Investimet kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë dhe aksesit në shërbime, duke rritur efikasitetin operacional dhe duke na mundësuar t'u përgjigjemi më mirë nevojave reale të përfituesve.

Një impakt i rëndësishëm është vërejtur edhe në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale, përmes pajisjeve moderne, trajnimeve të specializuara dhe transferimit të njohurive. Kjo ka ndihmuar stafin të punojë me metoda më bashkëkohore dhe më efektive, duke përmirësuar ndjeshëm proceset mësimore-edukative. Në të njëjtën kohë, këto nisma kanë kontribuar në zgjerimin e mbulimit dhe ndikimit, si në aspekt territorial ashtu edhe tematik. Për herë të parë, një pjesë e shërbimeve dhe aktiviteteve tona janë shtrirë edhe te fëmijët që nuk dëgjojnë dhe që arsimohen në shkolla të zakonshme, duke rritur përfshirjen dhe barazinë në akses.

Sa i përket ndryshimit të qëndrimeve dhe sjelljeve, kemi vërejtur një rritje të vetëbesimit, motivimit dhe angazhimit aktiv të nxënësve, si në procesin e të nxënësve, ashtu edhe në jetën sociale. Ata janë më të hapur ndaj bashkëpunimit, më të vetëdijshëm për aftësitë e tyre dhe më të përgatitur për integrimin social dhe profesional. Po ashtu, edhe stafi dhe prindërit tregojnë një nivel më të lartë besimi, përfshirjeje dhe bashkëpunimi me institucionin.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i impaktit lidhet me përmirësimin e transparencës dhe standardeve të menaxhimit, falë procedurave më të strukturuar dhe praktikave të mira të bashkëpunimit të ndërtuara me partnerët. Mbi të gjitha, këto nisma kanë krijuar vlerë të qëndrueshme, duke vendosur baza më të forta për zhvillimin institucional dhe vazhdimësinë e projekteve në të ardhmen.

Çfarë synoni të arrini në 5 vitet e ardhshme?

Duke u mbështetur në vlerësimin e impaktit të arritur deri më tani, institucioni ynë synon të sigurojë vijimësinë dhe zhvillimin e mëtejshëm të nismave të ndërtuara përmes bashkëpunimeve. Fokusi ynë do të jetë konsolidimi dhe institucionalizimi i këtyre nismave, në mënyrë që ato të jenë të qëndrueshme në kohë dhe të integruara plotësisht në veprimtarinë e përditshme të institucionit. Në të njëjtën kohë, synojmë të zgjerojmë fushat e bashkëpunimit, duke identifikuar nevojat dhe prioritetet e reja ku kontributi i sektorit privat mund të sjellë vlerë të shtuar. Kjo përfshin nxitjen e partneriteteve strategjike dhe diversifikimin e formave të mbështetjes, jo vetëm përmes investimeve apo dhurimeve, por edhe përmes bashkëpunimeve në fusha si inovacioni, teknologjia, trajnimi dhe transferimi i njohurive.

Në këtë kuadër, qendra mbetet e hapur ndaj bashkëpunimeve të reja me sektorin privat, të cilat kontribuojnë në mënyrë të qëndrueshme në përmbushjen e misionit institucional dhe në krijimin e vlerës publike afatgjatë. Besojmë se zhvillimi i vërtetë vjen nga partneritetet të ndërtuara mbi besim, përkushtim dhe vizion të përbashkët. Dhe siç na pëlqen ta themi shpesh, ne do të vazhdojmë të bëjmë "gjëra të vogla, por me dashuri të madhe", së bashku me bashkëpunëtorët të mirë, për të ndërtuar mundësi më të mëdha për fëmijët dhe të rinjtë që nuk dëgjojnë



F U S H A T A
N Ë N D I H M Ë T Ë
P E R S O N A V E
N Ë N E V O J Ë

Fushata

Disa nga fushatat e ngritura gjatë muajve
janar - dhjetor 2025.

#1

Llazi është një djalë nga Korça, me rezultate të shkëlqyera në shkollë dhe një vendosmëri të jashtëzakonshme. Por jeta nuk e ka kursyer nga sfidat. Humbja e gjyshes, një person i dashur që nuk mundi të mposhte një sëmundje, i la një boshllëk të madh në zemër. Megjithatë, kjo dhimbje u shndërrua në motiv: ai vendosi se një ditë do të bëhet mjek dhe do të shpëtojë jetë.

Sot, ëndrra e tij po merr formë. Përmes Bursës Elsa, të mundësuar nga Fundjavë Ndryshe, Llazi po ndjek ciklin e studimeve në mjeksi në Tiranë. Rruga është e gjatë dhe e vështirë, por zemra dhe vendosmëria e tij nuk dorëzohen.



NJË ËNDËRR QË PO BËHET REALITET

#2

Iniciativa e BALFIN Group dhe Mane Foundation për të mbështetur individë me aftësi të kufizuara në lëvizje ka përfunduar me sukses. 100 karrige me rrota janë shpërndarë në komunitete të ndryshme të vendit, duke sjellë ndihmë konkrete dhe përfshirje sociale për ata që kanë më shumë nevojë.

Kjo nismë është pjesë e angazhimit të vazhdueshëm të kompanive të grupit BALFIN për të krijuar mundësi për fëmijët dhe të rinjtë për arsim dhe shëndetësi cilësorë, si dhe për të mbështetur komunitetet në nevojë. Shpërndarja e karrigeve tregon qartë përkushtimin për të përmirësuar jetën e individëve dhe për t'i ndihmuar ata të jenë pjesë aktive e shoqërisë.

100 KARRIGE ME RROTA



#3

ABI Bank kontribuon në një shoqëri më të sigurt dhe të qëndrueshme duke mbështetur Policinë e Tiranës me 4 automjete elektrike. Kjo iniciativë përmirëson efikasitetin e punës së forcave policore në terren dhe rrit sigurinë për qytetarët e kryeqytetit.

Fushata tregon përkushtimin e bankës për një komunitet më të sigurt, miqësor ndaj mjedisit dhe të orientuar drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

SIGURIA PUBLIKE



NASA SPACE APPS CHALLENGE



#4

NASA Space Apps Challenge është konkursi më i madh ndërkombëtar i teknologjisë, i zhvilluar në 50 vende të botës, përfshirë Shqipërinë. 50 të rinj, studentë, ekspertë të teknologjisë dhe sipërmarrës sfiduan kreativitetin dhe dijet e tyre në një maratonë unike, duke përdorur të dhënat publike të NASA-s për të krijuar zgjidhje inovative me impakt global.

Qëllimi i fushatës ishte të nxiste inovacionin dhe të promovonte talentet e reja, ndërsa impakti i saj është vendosja e Shqipërisë në hartën ndërkombëtare të inovacionit dhe zhvillimi i aftësive të të rinjve për zgjidhje me ndikim global.

FESTË PËR TË MOSHUARIT



#5

Shpresë për Botën qëndroi pranë të moshuarve në Shtëpinë e të Moshuarve në Shkodër gjatë festave të fund-vitit, për t'u dhënë mundësinë të ndihen të shoqëruar dhe për të sjellë pak atmosferë feste. Ata morën pjesë në aktivitete të veçanta dhe përfunduan me shpërndarjen e dhuratave për secilin.

Qëllimi i fushatës ishte të ofronte gëzim dhe përkujdesje për të moshuarit, ndërsa impakti i saj u shpreh në rritjen e mirëqenies emocionale dhe ndjenjës së përkatësisë në komunitet, duke i bërë të ndihen të vlerësuar dhe të mbështetur.



F O N D A C I O N E T K O M U N I T A R E



Fondacionet Komunitare janë organizata jofitimprurëse që mobilizojnë burime lokale për të mbështetur iniciativa dhe projekte që adresojnë nevojat e komunitetit. Ato luajnë një rol kyç në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të atij komuniteti, duke promovuar filantropinë dhe pjesëmarrjen qytetare.

PJESËMARRJE NË TAKIME RAJONALE

Partnerët Shqipëri mori pjesë në takimin rajonal të zhvilluar më 22 tetor në Shkup, të organizuar nga European Community Foundation Initiative (ECFI) dhe Konekt, i cili mbledhi drejtues të fondacioneve komunitare dhe organizatave mbështetëse nga Ballkani për të diskutuar forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të këtij modeli në rajon. Diskutimet u përqendruan në kornizën e 4C-ve (Kapaciteti, Aftësitë, Kredibiliteti dhe Lidhjet), duke theksuar rëndësinë e kredibilitetit si aset kyç, ndërtimin dhe forcimin e lidhjeve, zhvillimin e aftësive organizative dhe eksplorimin e mënyrave për rritjen e kapacitetit financiar në një mjedis sfidues



Në vijim të këtij angazhimi rajonal, znj. Kostandina Kërti, Manaxhere Programi, Partnerët Shqipëri, mori pjesë edhe në Takimin Vjetor Evropian të ECFI, të zhvilluar më 24–25 nëntor në Vjenë, ku organizata mbështetëse të fondacioneve komunitare nga e gjithë Evropa shkëmbyen përvoja, forscan partneritetet dhe reflektojnë mbi rolin e filantropisë komunitare në një kontekst social dhe demokratik në zhvillim. Takimi u fokusua në zhvillimet kryesore të vitit 2025, përfshirë pjesëmarrjen e të rinjve, ndryshimet klimatike, reagimin ndaj emergjencave dhe ndërtimin e kapaciteteve lokale, si dhe në përcaktimin e prioriteteve për vitin 2026, duke shënuar njëkohësisht 10-vjetorin e ECFI.

RAPORTI KOMBËTAR “FONDACIONET KOMUNITARE NË SHQIPËRI”

Raporti Kombëtar “Fondacionet Komunitare në Shqipëri” paraqet vlerësimin e parë të thelluar mbi krijimin e fondacioneve komunitare, me një fokus të veçantë në modelin e parë të krijuar në vend, duke analizuar sfidat, mundësitë dhe potencialin e tyre për zhvillimin lokal. Analiza mbështetet në kornizën e 4C-ve (Kapaciteti, Aftësitë, Kredibiliteti dhe Lidhjet), duke evidentuar sfidat aktuale dhe duke identifikuar mundësi të rëndësishme për rritje përmes bashkëpunimit me komunitetin lokal, ndërtimit të partneriteteve me diasporën dhe sektorin privat, si dhe shfrytëzimit të platformave të crowdfunding.





Rruga e Elbasanit, ndërtesa Park Gate, kati 10,
App. 71 / 73, PO BOX 2418/1
1010 Tiranë, Shqipëri